

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI
I KURSIT TË UNIFIKUAR
“MOBILERI”

Kodi: PK-C-1-18

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2018

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“MOBILERI”

(PK-C-1-18)

I. Profili Profesional i mobilierit

a) Karakteristikat e mobilierit

Mobilieri është i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar në ndërmarrje të ndryshme si prodhues ose në mirëmbajtje, reparte dhe mini-reparte të ndryshme prodhimi mobiliesh.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, mobilierit duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe **shprehi** praktike që lidhen me veprimtarinë profesionale të mobilierit.

Suksesi i mobilierit është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e mobilierit:

Profesioni i mobilierit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për përpunimin e drurit për prodhime gjysmë të gatshme, si dhe përpunimin e elementëve gjysmë të gatshme (melaminës, kompensatës, MDF, fibrës etj.) në elementë për prodhimin e dyerve, mobilieve të ndryshme, prodhimeve artistike, riparimeve, prodhimin e varkave prej druri, tapiceri etj. Ai mund të punësohet në ndërmarrje të ndryshme si prodhues ose në mirëmbajtje, reparte dhe mini-reparte të ndryshme prodhimi mobiliesh apo të vetëpunësohet. Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e mobilierit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një mobilier mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit të përpunimit të drurit.

Për të zhvilluar aktivitet privat dhe për vetëpunësim, në fushën e mobilerisë duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Prodhues i mobilieve dhe të tjerë të ngjashëm”, me kod 7522, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: makinist për përpunimin e drurit, montues mobiliesh, prodhues i lëndës së sharruar, projektues për prodhimin e mobilieve, karpentier, mirëmbajtës të prodhimeve prej druri etj.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për Mobileri

Në përfundin të Kursit për mobileri, kursantët do të jenë të aftë të:

- Përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin teknik për mobileri.
- Bëjnë organizimin e vogël të punës në repartin e mobilerisë.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në mjediset e punës.
- Përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet, makineritë dhe materialet e duhura të punës.
- Mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe makineritë në mjedisin e punës.

- Përdorin vizatime teknike dhe interpretojnë skica dhe projekte të thjeshta të mobilerisë.
- Kryejnë vizatime dhe matje të ndryshme në mobileri;
- Kryejnë punime të mobilerisë me vegla dhe pajisje dore;
- Kryejnë punime të mobilerisë me makinat bazë të përpunimit të drurit;
- Prodhonjë mobilie prej druri;
- Prodhonjë mobilie prej melamine dhe MDF;
- Zbatonjë standardet e profesionit gjatë prodhimit të mobilie.
- Komunikonjë me etikë me eprorët, kolegët dhe klientët.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për Mobileri.

Pjesëmarrësit në Kursin për mobileri duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë mendërisht dhe fizikisht dhe të jenë mbi 16 vjeç.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për Mobileri

360 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për Mobileri

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e mobilierit.	MK-09.045-18	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime;	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit mobilierit. 2. Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet, instrumentet dhe makinat kryesore që përdoren në mobileri. 3. Kursanti përshkruan lëndët e para që përdoren në mobileri. 4. Kursanti përshkruan lëndët e drusore që përdoren në mobileri. 5. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.
2	Vizatime dhe matje në mobileri	MK-09.046-18	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	1. Kursanti lexon dhe interpreton vizatime teknike të thjeshta. 2. Kursanti kryen matje, kontrolle dhe shënime në materiale dhe objekte të ndryshme të mobilerisë. 3. Kursanti përgatit skica të objekteve të thjeshta të mobilerisë. 4. Kursanti ndërton “tabelën e prerjes”.

3	Punime të mobilerisë me vegla dhe pajisje dore.	MK-09-.047-18	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti parapërgatit proceset e përpunimit të materialit me vegla dhe pajisje dore. 2. Kursanti kryen punime sharrimi. 3. Kursanti kryen punime zdruthimi. 4. Kursanti kryen punime axhustimi. 5. Kursanti kryen punime shpimi-pastrimi. 6. Kursanti kryen punime lustrimi. 7. Kursanti kryen punime bashkimi të elementeve të mobilieve.
4	Punime me makinat bazë të përpunimit të drurit	MK-09-.048-18	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit punimet me makinat bazë të përpunimit të drurit. 2. Kursanti kryen punime me makinat sharrë. 3. Kursanti kryen punime me makinat plan grosecë. 4. Kursanti kryen punime me makinat e zumparimit. 5. Kursanti kryen punime me makinat e shpimit. 6. Kursanti kryen punime me makinat e frezimit. 7. Kursanti kryen punime me makinat e thithëzimit.
5	Prodhime mobilerie prej druri	MK-09-.049-18	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti parapërgatit prodhimin e mobilieve prej druri. 2. Kursanti përgatit elementet për prodhimin e mobilieve prej druri. 3. Kursanti prodhon mobilie prej druri.
6	Prodhime mobilerie prej melamine dhe MDF.	MK-.09-.050-18	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti parapërgatit prodhimin e mobilieve me melaminë dhe MDF. 2. Kursanti përgatit elementet për prodhimin e mobilieve me melaminë dhe MDF. 3. Kursanti prodhon mobilie me melaminë dhe MDF.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Mobileri

1. Moduli “Hyrje në profesionin e mobilierit”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E MOBILIERIT.	MK-09-045-18
Qëllimi i modulit	Nje modul teorik e praktik që i njeh kursantët me veçoritë, funksionet, detyrat dhe kërkesat e profesionit të mobilierit, me mjedisin, veglat, pajisjet, instrumentat, makinat dhe materialet e punës, me lëndët drusore që përdoren në mobileri, si dhe me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë fizikisht e mendërisht dhe të jenë mbi 16-vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të mobilierit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit; - të përshkruajë vendin dhe kushtet e punës së mobilierit; - të tregojë cilat janë kërkesat profesionale të mobilierit; - të tregojë cilat janë prodhimet kryesore të mobilerisë; - të rendisë detyrat kryesore të mobilerisë; - të shpjegojë mundësitë e përparimit në profesionin e mobilierit; - të tregojë mundësitë e punësimit të mobilierit; Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Pyetje përgjigje me shkrim. RM 2 Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet, instrumentet dhe makinat kryesore që përdoren në mobileri. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të përshkruajë mjedisin e punës së mobilierit; - të dallojë veglat që përdoren në mobileri; - të përshkruajë përdorimin e veglave; - të përshkruajë kujdesin dhe mirëmbajtjen ndaj veglave; - të dallojë pajisjet që përdoren në mobileri; - të tregojë përdorimin e pajisjeve të mobilerisë; - të përshkruajë kujdesin dhe mirëmbajtjen ndaj pajisjeve të	

- mobilerisë;
- të dallojë instrumentat e prerës;
- të tregojë përdorimin e instrumentave prerës;
- të përshkruajë kujdesin dhe mirëmbajtjen ndaj instrumentave prerës;
- të dallojë makinat kryesore që përdoren;
- të tregojë përdorimin dhe kujdesin ndaj makinave kryesore;
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit
- të tregojë si jepet ndihma e parë për të dëmtuarit në punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan lëndët e para që përdoren në mobileri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të dallojë drurin masiv, dërrasat, trarët, listelat;
- të tregojë përmasat standarde dhe përdorimin e tyre;
- të dallojë pllakat e fibrës dhe tregojë llojet, përmasat dhe standardet e përdorimit të tyre;
- të dallojë pllakat zdrukhtare dhe tregojë llojet, përmasat dhe standarde e përdorimit të tyre.
- të dallojë materialet e tjera si xhami, plastika, metali dhe tregojë përdorimet e tyre;
- të dallojë lëndët ngjitëse që përdoren në mobileri dhe tregojë llojet e përdorimit të tyre.
- të dallojë lëndët mbrojtëse dhe dekoruese të drurit;
- të tregojë llojet e përdorimit të lëndëve mbrojtëse dhe dekoruese të drurit;
- të dallojë elementet lidhëse si gozhdet, vidat, bulonat, kunjat etj.;
- të tregojë përmasat standarde të përdorimit të elementeve lidhëse;
- të dallojë aksesoret si menteshat, rrëshqitësit, dorezat, bravat etj.;
- të tregojë llojet e përdorimit të aksesorëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 4 Kursanti përshkruan lëndët drusore që përdoren në mobileri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë ndërtimin e brendshëm të drurit;
- të dallojë llojet kryesore të drurëve që përdoren në mobileri;

- të tregojë veçoritë, vetitë dhe përdorimet e drurëve.
- të përshkruajë rregullat e ruajtjes dhe mbrojtjes së lëndëve drusore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 5 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë rregulloren e sigurimit teknik;
- të përcaktojë rreziqet kryesore që mund të ndodhin;
- të përcaktojë shkaqet e rreziqeve të mundshme;
- të përcaktojë masat dhe veprimet për mënjanimin e rreziqeve të mundshme;
- të përcaktojë pasojat nga moszbatimi i rregullores së sigurimit teknik;
- të përcaktojë, në përputhje me standardet e miratuara, masat dhe veprimet e dhënies së ndihmës së parë sipas rasteve konkrete;
- të përcaktojë masat dhe veprimet që ndërmerren në rast rreziku nga rryma elektrike, sipas rregullores së sigurimit teknik;
- të përcaktojë masat dhe veprimet që ndërmerren në rast rreziku nga përmytjet, sipas rregullores së sigurimit teknik;
- të përcaktojë masat dhe veprimet që ndërmerren në rast rreziku nga zjarri, sipas rregullores së sigurimit teknik;
- të përcaktojë, në përputhje me standardet e miratuara, masat dhe veprimet e dhënies së ndihmës së parë sipas rasteve konkrete;
- të përshkruajë masat për ruajtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarive profesionale të mobilierit.
- të planifikojë masat e sigurisë në punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli..

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në repartin e zdrukthtarisë dhe në klasë për mësimet teorike. Rekomandohet dhe kryerja e vizitave mësimore dhe praktikimi i kursantëve në biznese lokale që kryejnë punime mobiliare.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete gjatë shpjegimit të veçorive të profesionit të mobilierit si dhe të njohjes së kursantëve me mjetet e punës, lëndët e para dhe prodhimet në mobilerit dhe rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.

	– Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli. – Kursantët duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me rastet e ndryshme që paraqiten. – Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të fituara nga ata.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klase për teorinë. - Repart mobilerie. - Komplet i veglave, pajisjeve, instrumentave dhe makinave që përdoren në mobileri. - Lëndë të para dhe materiale të tjera që përdoren në mobileri. - Pankarta, makete, katalloge të prodhimeve të mobilerisë. - Materiale të shkruara (manuale, rregullore, katalloge).

2. Moduli: “Vizatime dhe matje në mobileri”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	VIZATIME DHE MATJE NË MOBILERI.	MK-09-046-18
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për të lexuar e interpretuar vizatimet teknike e skicat e mobilerisë, për të përgatitur skica të ndryshme, si dhe për të kryer matje e kontrole që përdoren në mobileri.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht, të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë përfunduar modulin 1: “Hyrje në profesionin e mobilierit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti lexon dhe interpreton vizatime teknike të thjeshta. Kriteret e realizimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të lexojë dhe interpretojë projeksionet ortogonale të objekteve të thjeshta; - të lexojë dhe interpretojë prerjet dhe seksionet e prerjeve; - të lexojë dhe interpretojë shenjat konvencionale dhe standardet; - të lexojë dhe interpretojë kuotimin dhe shmangiet nga përmasat nominale; - të lexojë dhe interpretojë paraqitjet aksonometrike; - të lexojë dhe interpretojë paraqitjet perspektive. Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. – Pyetje – përgjigje me gojë.	
	RM 2 Kursanti kryen matje, kontrole dhe shënime në materiale dhe objekte të ndryshme mobilerie. Kriteret e realizimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të përzgjedhë drejt instrumentat matëse; – të tregojë llojet dhe përdorimin e instrumentave matëse; – të përzgjedhë drejt instrumentat kontrollues; – të tregojë llojet dhe përdorimin e instrumentave kontrollues; – të përzgjedhë drejt pajisjet për matje, kontrole dhe shënime; – të tregojë llojet dhe përdorimet e pajisjeve për matje, kontrole dhe shënime; – të kryejë saktë matje në materiale dhe objekte të ndryshme të mobilerisë; – të kryejë saktë kontrole në materiale dhe objekte të	

- ndryshme të mobilerisë;
- të kryejë shënime në materiale dhe objekte të ndryshme të mobilerisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

RM 3 Kursanti përgatit skica të objekteve të thjeshta të mobilerisë.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të lexojë dhe interpretojë skicat e objekteve të thjeshta të mobilerisë;
- të tregojë veçoritë e skicave të objekteve të ndryshme të mobilerisë;
- të respektojë rregullat e skicimit të objekteve të ndryshme të mobilerisë;
- të kryejë skicimin e objekteve të thjeshta, tipike të mobilerisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

RM 4 Kursanti ndërton “tabelën e prerjes” të objekteve të thjeshta të mobilerisë.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të zbërthejë skicat e objekteve të thjeshta të mobilerisë në elementet përkatës;
- të vendosë përmasat e tabakut të materialit që do të përdoret, në tabelë ose në kompjuter;
- të vendosë saktë përmasat e të gjithë elementeve të objektit të mobilerisë që do të prodhohet;
- të përpunojë në tabelë ose në kompjuter të dhënat e vendosura të elementeve të objektit të mobilerisë;
- të hartojë preventivin e materialeve sipas kërkesës për objektin e mobilerisë;
- të respektojë rregullat e ndërtimit të “tabelës së prerjes” së objekteve të ndryshme të mobilerisë;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant, profesionale të përpunim drurit dhe në klasë për mësim të teorisë. Rekomandohet dhe kryerja e vizitave mësimore dhe praktikimi i kursantëve në biznese lokale që kryejnë punime mobiliare.

- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete gjatë shpjegimit të çështjeve që lidhen me vizatimet e skicat si dhe matjet,

	kontrollat e shënimeve e objekteve të mobilerisë. – Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete të interpretimit të vizatimeve e skicave, skicimit, matjeve, kontrolleve e shënimeve. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me rastet e ndryshme që paraqiten. – Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të fituara nga ata. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune - Klase për teorinë. Objekte të ndryshme mobilerie për t'u skicuar. - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumentave për skicim, matje, kontroll e shënim. - Modele të vizatimeve teknike e skicave të mobilerisë. - Pankarta, makete, kataloge. - Materiale të shkruara (manuale, rregullore, kataloge).

3. Moduli: “Punime të mobilerisë me vegla dhe pajisje dore”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME TË MOBILIERISË ME VEGLA DHE PAJISJE DORE.	MK-09-047-18
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantët për të kryer procese pune të sharrimit, zdruthimit, axhustimit, shpimit në materialin drunor me vegla dhe pajisje dore.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë të aftë mendërisht dhe fizikisht dhe të jenë mbi 16 vjeç. Kursanti duhet të ketë përfunduar me sukses modulin1: “Hyrje në profesionin e mobilierit”, modulin 2: “Vizatime dhe matje në mobileri”	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përgatit proceset e përpunimit të materialit me vegla dhe pajisje dore. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të veshë uniformën e punës; – të analizojë dhe interpretojë vizatime dhe skica të punimeve të thjeshta në materialin – të përshkruajë saktë radhën e punimeve; – të zgjedhë materialin e punës sipas prodhimit, përdorimit dhënies së formës dhe lagështisë së drurit; – të zgjedhë, sipas procesit të punës,veglat prerëse; – të zgjedhë mjetet matëse, shënuese dhe kontrolluese; – të vendosë, me kujdes, materialin, veglat, pajisjet dhe instrumentet prerës në vendin përkatës të punës; Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. – Pyetje – përgjigje me gojë. RM 2 Kursanti kryen punime sharrimi. Kriteret e realizimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : – të matë dhe shënojë materialin sipas skicës; – të mprehë sharrën sipas parametrave këndorë; – të bëjë çaprazimin sipas lartësisë së dhëmbit me çelës të thjeshtë çaprazi; – të sharrojë materialin, sipas shënimit, me sharra të ndryshme dore; – të sharrojë materialin, sipas shënimit, me sharrë dore elektrike; – të kontrollojë sharrimet, sipas shënimit;	

- të mirëmbajë sharrat, pajisjet matëse dhe kontrolluese;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me sharra dore të thjeshtë dhe elektrike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

RM 3 Kursanti kryen punime zdruthimi.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të matë saktë dhe shënojë materialin sipas skicës;
- të mprehë thikën e zdrukthit sipas parametrave këndorë;.
- të zdukthojë materialin me zdrukthe të ndryshme dore të thjeshtë, sipas shënimit;
- të zdukthojë materialin me zdrukth të mekanizuar të dorës, sipas shënimit;
- të kontrollojë materialet e zdrukthtuara, sipas skicës;
- të mirëmbajë zdrukthet dhe pajisjet matëse dhe kontrolluese;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me zdrukthe dore dhe të mekanizuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

RM 4 Kursanti kryen punime axhustimi.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shënojë materialin sipas skicës;
- të përgatitë veglën prerëse për punë, sipas parametrave;
- të punojë me daltë materialin sipas shënimit;
- të rrashinojë materialin drunor sipas skicës;
- të punojë me limë sipas modelit;
- të zumparojë materialin drunor sipas shkallës të pastërtisë, me dorë dhe pajisje zumparimi elektrike;
- të kontrollojë me kujdes punimet e bëra;
- të mirëmbajë me kujdes veglat prerëse, pajisjet matëse dhe kontrolluese.
- të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me dalta, rrashina, lima dhe leter zumpare;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

RM 5 Kursanti kryen punime shpimi – pastrimi.

Kriteret e realizimit

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të matë saktë dhe shënojnë materialin sipas skicës;
- të përgatisë veglën prerëse për punë, sipas diametrit të shpimit;
- të shpojë detalet sipas shënimit, me trapano elektrike dore;
- të pastrojë me kujdes mbeturinat e ashklave;
- të kontrollojnë sipas përmasave në skicë foletë e kryera;
- të mirëmbajnë me kujdes veglat e shpimit me dorë, pajisjet matëse dhe kontrolluese;
- të zbatojnë me kujdes rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me veglat e shpimit me dorë

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

RM 6 Kursanti kryen punime lustrimi.

Kriteret e realizimit

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të organizojë vendin e punës për lustrimin e mobilieve sipas modelit të kërkuar;
- të përcaktojë llojin e llustrimit, ngjyrën etj.;
- të llogaritë sasinë e lëndës ngjitëse të nevojshme sipas normativës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme për lustrim;
- të përgatisë veglat, pajisjet dhe makinat për lustrim;
- të përgatitë sipërfaqen e mobilies për lustrim;
- të zumparojë sipërfaqen e mobilies sipas shkallës të pastërtisë;
- të përgatitë bojën, solucionin e lustrimit sipas recetës;
- të ngjyrosë sipërfaqen e mobilies sipas kërkesës;
- të lyejë me pastë poliuretan për mbushjen e poreve në sipërfaqen e mobilies;
- të thajë shtresën e pastës në mënyrë natyrore;
- të zumparojë me letër zumpare të imët sipërfaqen e mobilies së lyer me pastë poliuretani;
- të pastrojë me kujdes sipërfaqen e zumaruar;
- të kontrollojë defekte të vogla të bojës dhe të poreve nëse ka sipërfaqja e mobilies;
- të eliminojë defektet duke stukur apo duke lyer me bojë;
- të lyejë me poliuretan sipërfaqen me splucim (me pistoletë);
- të thajë në mënyrë natyrore shtresën e llustrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë lustrimit të sipërfaqeve të mobilieve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

RM 7 Kursanti kryen punime bashkimi të elementeve të mobilie.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë dhe shënojë materialin sipas skicës.
- të përgatisë pajisjet e mekanizuara të dorës për profilim dhe ngjitje, për punë;
- të hapë kanale me frezë të mekanizuar dore, sipas shënimit;
- të realizojë profilim të detalit me frezë të mekanizuar dore sipas skicës;
- të shkallëzojë materialin me frezë të mekanizuar dore sipas modelit;
- të realizojë mbërthime dhe vidime në materialin drunor;
- të ngjitë teni, rimeso, plastikë sipas kërkesës, në brinjë me pajisje të mekanizuar të dorës;
- të pastrojë me kujdes tepricat e tenisë;
- të mbërthejë me grafitë elementet prej druri;
- të mirëmbajë pajisjet e mekanizuara të dorës për profilim dhe ngjitje, mjetet matëse dhe kontrolluese;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punime të ngjitjes së elementeve të mobilie me vegla dhe të thjeshta dhe të mekanizuara të dorës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikantë profesionalë të përpunimit drurit. Rekomandohet dhe kryerja e vizitave mësimore dhe praktikimi i kursantëve në biznese lokale që kryejnë punime mobiliare.

- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të matjes, shënimit, sharrimit, zdrukthimit, axhustimit, shpim-pastrimit, montimit dhe lyerjes e llakimit etj.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve në matje, shënime, sharrime, zdrukthime shpime, pastrime, lustrimi dhe bashkimi etj., fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës me vegla dhe pajisje dore të përpunimit të drurit dhe materialeve me bazë druri, melamine dhe MDF.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës me vegla dhe pajisje dore të përpunimit të drurit dhe materialeve me bazë druri, melamine dhe MDF.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për realizimin e proceseve të punës me vegla dore.
- Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për procese pune me vegla dore.
- Lëndë e parë.
- Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli: “Punime me makinat bazë të përpunimit të drurit”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PUNIME ME MAKINAT BAZË TË PËRPUNIMIT TË DRURIT.	MK-09-048-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të kryer procese pune, në materialin drunor me makinat sharrë, plan grosecë, zumparimit, shpimit, frezimit dhe thithëzimit.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht të jënë mbi 16-vjec. Kursanti duhet të ketë përfunduar me sukses modulin1: “Hyrje në profesionin e mobilierit”, modulin 2: “Vizatime dhe matje në mobileri” dhe modulin 3: “Punime të mobilerisë me vegla dhe pajisje dore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përgatit punimet me makinat bazë të përpunimit të drurit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të rikujtojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit; – të veshë uniformën e punës; – të analizojë dhe interpretojë vizatime dhe skica të punimeve të thjeshta në materialin drunor; – të përshkruajë saktë radhën e punimeve; – të zgjedhë materialin e punës sipas prodhimit, përdorimit dhënies së formës dhe lagështisë së drurit; – të zgjedhë makinën e përpunimit të drurit, sipas procesit të punës; – të zgjedhë instrumentet prerës – të mprehë instrumentet prerës – të zëvendësojë instrumentet prerës – të zgjedhë mjetet matëse, shënuese dhe kontrolluese sipas kërkesës; – të vendosë materialin pranë makinës me kujdes; – të rregullojë parametrat e punës së makinës; – të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët; Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. – Pyetje – përgjigje me gojë.	

RM 2 Kursanti kryen punime me makinat sharrë.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të matë dhe shënojë materialin sipas skicës;
- të vendosë dhe fiksojë materialin në makinë;
- të mprehë sharrën sipas parametrave këndorë;
- të bëjë çaprazimin me çelës të thjeshtë çaprazi sipas lartësisë të dhëmbit;
- të sharrojë materialin me makinë sharrë shirit sipas shënimit;
- të shkurtojë materialin me makinë sharrë disk sipas shënimit;
- të kontrollojë sharrimet sipas shënimit;
- të kontrollojë materialet e sharruara me makina sipas skicës;
- të mirëmbajë makinat sharre shirit dhe disk, pajisjet matëse dhe kontrollues;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me makinat e sharrimit.
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë

RM 3 Kursanti kryen punime me makinat plan grosecë.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë makinat për punë sipas trashesisë të materialit;
- të drejtojë materialin në sipërfaqe sipas kërkesës në makinën plan drejtuese;
- të drejtojë materialin në brinjë sipas kërkesës në makinën plan drejtuese;
- të kontrollojë me kujdes saktësinë e drejtimit;
- të realizojë sipas skicë trashësinë e materialit në makinën grosecë;
- të kontrollojë me kujdes nxjerrjen e trashësisë;
- të mirëmbajë me kujdes thikat, makinat plan, grosecë, pajisjet matëse dhe kontrolluese;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me makinën plan dhe grosecë;
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

- Pyetje – përgjigje me gojë

RM 4 Kursanti kryen punime me makinat e zumparimit.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të vendosë materialin pranë makinës me kujdes;
- të përgatisë makinën për punë sipas parametrave të kërkuara;
- të vendosë llojin e duhur të instrumentit zumpares;
- të bëjë zumparime të elementeve në sipërfaqe;
- të bëjë zumparimin e elementeve në brinjë;
- të bëjë zumparimin e elementeve në qoshe;
- të bëjë zumparime në punime të rrumbullakta;
- të mirëmbajë siç duhet makinat e zumparimit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve me makina zumparimi.
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë

RM 5 Kursanti kryen punime me makinat e shpimit.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të vendosë materialin pranë makinës me kujdes;
- të rregullojë parametrat e punës së makinës;
- të vendosë llojin e duhur të instrumentit shpues;
- të matë dhe të shënojë elementet sipas skicës;
- të shpojë me kujdes elementet me shumë punto;
- të realizojë shpimet vertikale me shumë punto;
- të realizojë shpimet horizontale me shumë punto;
- të kontrollojë sipas modelit shpimet e bëra;
- të kujdeset për veglat, pajisjet dhe makinat e shpimit me shumë punto;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në punimet me makinat e shpimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

RM 6 Kursanti kryen punime me makinat e frezimit.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të vendosë materialin pranë makinës me kujdes;
- të rregullojë parametrat e punës së makinës;
- të vendosë llojin e duhur të instrumentit frezues;
- të matë dhe të shënojë elementet sipas skicës;
- të bëjë profilimin e elementeve sipas modelit;

- të realizojë bërjen e thithave për lidhje;
- të hapë kanalet sipas përmasave në skicë;
- të realizojë shkallëzimet e elementeve sipas modelit;
- të realizojë bastunet sipas diametrit në skicë;
- të hapë fole me freze zinxhir;
- të realizojë kopjimin e elementeve me freze kopjuese sipas modelit;
- të bëjë punime frezimi me kompjuter;
- të kontrollojë punimet e bëra me mjete kontrolli sipas skicës apo modelit;
- të kujdeset për makinat, pajisjet dhe instrumentet;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit në punimin me makinat e frezimit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë

RM 7 Kursanti kryen punime me makinat e thithëzimit.

Kriteret e realizimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të vendosë materialin pranë makinës me kujdes;
- të rregullojë parametrat e punës së makinës;
- të vendosë llojin e duhur të instrumentit thithëzues;
- të matë dhe të shënojë elementet sipas skicës;
- të shkurtojë elementet me përmasa fikse;
- të realizojë supet e thithit sipas skicës;
- të zbulojë me kujdes thithin;
- të realizojë foletë në kokat e elementeve;
- të punojë elementet në makinën e thithëzimit njëanësore dhe dyanësore sipas skicës;
- të kontrollojë punimet e bëra;
- të mirëmbajë makinat, pajisjet dhe instrumentat prerës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit në punimet me makinat e thithëzimit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikantë profesionalë të përpunimit drurit (zdukthari). Rekomandohet dhe kryerja e vizitave mësimore dhe praktikimi i kursantëve në biznese lokale që kryejnë punime mobiliare.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të së proceseve të punës me makinat sharrë, grosecë, të zumparimit, të shpimit, të frezimit dhe të thithëzimit.
- Kursanti duhet të angazhohet në veprimtari konkrete të proceseve të punës me makinat sharrë, grosecë dhe të zumparimit.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës

	të zumparimit, të shpimit, të frezimit dhe të thithëzimit me makina bazë të përpunimit të drurit. – Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të zumparimit, të shpimit, të frezimit dhe të thithëzimit me makina bazë të përpunimit të drurit. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për realizimin e proceseve të punës me makina bazë të përpunimit të drurit. – Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për procese pune me makina bazë të përpunimit të drurit. – Lëndë e parë. – Makinat bazë të përpunimit të drurit. – Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

5. Moduli “Prodhime mobilerie prej druri”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PRODHIME MOBILIERIE PREJ DRURI	MK-09-049-18
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për të prodhuar mobilie të ndryshme prej druri si: karrige, tavolina, dollap rrobash, kremastar, korniza etj.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht. Të jetë mbi 16 vjeç. Kursanti duhet të ketë përfunduar me sukses modulën 1: “Hyrtje në profesionin e mobilierit” dhe modulën 2: “Vizatimet dhe matjet në mobilerit” dhe modulën 3: “Punime të mobilerisë me vegla dhe pajisje dore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti parapërgatit prodhimin e mobilieve prej druri. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të rikujtojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit; – të organizojë vendin e punës për prodhimin e mobilieve prej druri; – të zbërthejë saktë skicat e mobilieve prej druri; – të përgatitë saktë “tabelën e prerjes”; – të përzgjedhë saktë materialet për prodhimin e mobilieve prej druri; – të përzgjedhë drejt veglat, pajisjet dhe makinat që nevojiten për prodhimin e mobilieve prej druri; – të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët; Instrumentet e vlerësimit: – Vëzhgim me listë kontrolli. – Pyetje – përgjigje me gojë. RM 2 Kursanti përgatit elementet për prodhimin e mobilieve prej druri. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të matë dhe të shënojë mbi materialin drusor sipas përmasave të kërkuara për prodhimin e mobilieve; - të shkurtojë materialin me mbishtesat e kërkuara në makinat e shkurtimit; - të drejtojë materialin e shkurtuar në brinjë në makinën plan; - të sharrojë materialin në gjatësi në makinën sharrë shirit apo disk me mbishtesat e nevojshme;	

- të bëjë drejtimin e elementeve në faqe dhe brinjë në makinën plan-drejtues;
- të realizojë trashësinë e elementeve të mobilies sipas skicës në grosecë;
- të shkurtojë në përmasat fikse elementët e mobilies në makinën shkurtuese universale.
- të ndajë dhe të bëjë shënime të elementët për shpimin dhe thithëzimin e tyre;
- të birojë elementët me makina shpimi me shumë punto ose frezë me zinxhir sipas përmasave në skicë;
- të bëjë thithëzimin e elementeve të mobilies duke u përshtatur foleve në makinat sharrë disk, frezë thithëzimi;
- të bëjë profilimin dhe paturën në elementet e mobilies me makinën frezë;
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve, për përgatitjen e elementeve, të mobilieve prej druri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

RM 3 Kursanti prodhon mobilien prej druri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të montojë paraprakisht elementet e mobilies prej druri;
- të evidentojë gabimet e mundshme;
- të korrigjojë gabimet e evidentuara;
- të lyejë me bojë ose llak sipas kërkesës mobilien prej druri;
- të montojë me lëndë ngjitëse elementet e mobilies prej druri;
- të shtrëngojë me morseta elementet e mobilies prej druri;
- të fshijë lëndën ngjitëse të tepërt nga elementet e ngjitur të mobilies prej druri;
- të zumparojë mobilien prej druri sipas shkallës të pastërtisë;
- të vendosi menteshat në mobilie dhe në kasë sipas skicës;
- të vendosi dorezat në mobilien prej druri sipas modelit;
- të lyejë mobilien prej druri sipas kërkesës me vaj lini dhe më pas me poliuretan;
- të montojë mobilien prej druri në hapësirën e matur më parë;
- të vendosë dorezat në mobilien prej druri sipas modelit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e mobilies prej druri;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

**Udhëzime për
zbatimin e modulit**

Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale të përpunim drurit (zdrukthari). Rekomandohet dhe kryerja e vizitave mësimore dhe praktikimi i kursantëve në biznese lokale që kryejnë punime mobiliare.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të në matje, shënime, shurtime, sharrime dhe montimin e mobilieve prej druri.
- Kursanti duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve në matje, shënime, shurtime, sharrime dhe montimin e mobilieve prej druri, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin e mobilieve prej druri.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e prodhimit të mobilieve prej druri.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për matjen dhe prejen e lëndës së parë.
 - Komploti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime zdrukthare.
 - Lëndë e parë.
 - Aksesore të ndryshëm.
 - Katalloge, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

6. Moduli: “Prodhime mobilerie prej melamine dhe MDF”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PRODHIME MOBILIERIE PREJ MELAMINE DHE MDF.	MK-09-050-18
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për të prodhuar mobilie të ndryshme prej melamine dhe MDF.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht. Të jetë mbi 16 vjeç. Kursanti duhet të ketë përfunduar me sukses modulën 1: “Hyrje në profesionin e mobilierit” dhe modulën 2: “Vizatimet dhe matjet në mobilerit” dhe modulën 3: “Punime të mobilerisë me vegla dhe pajisje dore”.	

Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit

RM 1 Kursanti parapërgatit prodhimin e mobilieve me melaminë dhe MDF.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të rikujtojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit;
- të organizojë vendin e punës për prodhimin e mobilieve prej melamine dhe MDF;
- të zbërthejë saktë skicat e mobilieve prej melamine dhe MDF;
- të përgatitë saktë “tabelën e prerjes”;
- të përzgjedhë saktë materialet për prodhimin e mobilieve prej melamine dhe MDF;
- të përzgjedhë drejt veglat, pajisjet dhe makinat që nevojiten për prodhimin e mobilieve prej melamine dhe MDF;
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

RM 2 Kursanti përgatit elementet për prodhimin e mobilieve me melaminë dhe MDF.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë makinën plandrejtuuese dhe grosecë për drejtimin e lëndës së parë;
- të vendosë saktë skuadrin në makinë;
- të drejtojë elementet e mobilies sipas skicës;

- të kontrollojë matjen e elementeve të drejtuara;
- të përzgjedhë saktë veglat dhe pajisjet për lidhjen dhe bashkimin e elementeve;
- të masë dhe shënojë elementet, sipas skicës;
- të përgatisë makinën për prerje të elementeve sipas skicës;
- të vendosë skuadrin në makinë, sipas përmasave;
- të hapë kanalin në traversën gjatësore të telajos;
- të përgatitë faqet e thithave sipas përmasave;
- të kontrollojë cilësinë e lidhjeve;
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve, për përgatitjen e elementeve, të mobilieve prej melamine dhe MDF.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

RM 3 Kursanti prodhon mobilien me melaminë dhe MDF.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të montojë paraprakisht elementet e mobilies prej melamine dhe MDF;
- të evidentojë gabimet e mundshme;
- të korrigjojë gabimet e evidentuara;
- të lyejë me bojë ose llak sipas kërkesës mobilien melamine dhe MDF;
- të montojë me lëndë ngjitëse elementet e mobilies prej melamine dhe MDF;
- të shtrëngojë me morseta elementet e mobilies prej melamine dhe MDF;
- të fshijë lëndën ngjitëse të tepërt nga elementet e ngjitur të mobilies melamine dhe MDF;
- të zumparojë mobilien prej melamine dhe MDF sipas shkallës të pastërtisë;
- të vendosi menteshat në mobilie dhe në kasë sipas skicës;
- të vendosi dorezat në mobilie sipas modelit;
- të lyejë mobilien prej melamine dhe MDF sipas kërkesës me vaj lini dhe më pas me poliuretan;
- të montojë mobilien në hapësirën e matur më parë;
- të vendosë dorezat në mobilie sipas modelit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e mobilies prej melamine dhe MDF;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit	Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale të përpunim drurit (zdrukthari). Rekomandohet dhe kryerja e vizitave mësimore dhe praktikimi i kursantëve në biznese lokale që kryejnë punime mobiliare. – Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të në matje, shënime, shurtime, sharrime dhe montimin e mobilieve prej melamine dhe MDF. – Kursanti duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve në matje, shënime, shurtime, sharrime dhe montimin e mobilieve prej melamine dhe MDF, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin e mobilieve prej melamine dhe MDF. – Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e prodhimit të mobilieve prej melamine dhe MDF. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për matjen dhe prejen e lëndës së parë. – Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime zdrukthare. – Lëndë e parë. – Aksesore të ndryshëm. – Katalloge, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.